



Motër Teuta Buka

Koordinatorë Kombëtare e Edukimit Katolik Shqiptar

Qasja e barabartë në mundësitë e të mësuarit me cilësi të lartë është një e drejtë themelore e njeriut për të gjithë dhe një gur themeli i kohezionit social. Programet arsimore nën Konventat Kulturore Evropiane kërkohen gjithnjë e më shumë për të adresuar sfidat të përfshirjes sociale për grupet e cenushme dhe të ndërtimit të demokracisë së bashku, shoqëri të begata, të qëndrueshme, tolerante dhe kohezive. Qëllimi kryesor i edukimit në të ardhmen programet në të dyja kontekstet e të mësuarit formal dhe joformal do të jenë zhvillimi i politikave, standardeve dhe praktikave arsimore për cilësinë gjatë gjithë jetës të mësuarit, me fokus të veçantë në vlerat, si dhe në qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për një qytetari shoqërore gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe aktive me një kulturë demokratike

[Video](#)

Qasja jonë: dialog dhe përkujdesje për çdo person, përmes shoqërimit që u bëhet fëmijëve dhe familjeve. Ne bazohemi në vlerat e ungjillit: dinjiteti njerëzor, respekti, ndershmëria, drejtësia ...

Shkollat tona janë përherë në kërkim të metodologjive të reja për një formim të plotë të fëmijës, duke pasur në vëmendje se edukimi është një e mirë publike.

Ne synojmë ndryshimin e mendësisë mbi institucionet edukative që do të shpjerë edhe në ndryshime ligjore, duke pasur në qendër njeriun, vlerat, përjasjen edukative, mësues të motivuar e të formuar me etikë personale dhe profesionale.

Për të shmangur uniformizimin dhe për të siguruar mundësinë e zgjedhjes në arsim, duhet edhe një kuadër i ri ligjor me vizion të ri për edukimin.

Pluralizmi si garanci për një arsim më cilësor dhe për të gjithë në Shqipëri.

Hyrje

Te nderuar sic dhe e permenda ne fjalën time hyrëse Dialogu dhe Përkujdesja janë dy mënyra si ne e shohim praninë tonë në lëmin e Edukimit si dhe në krah të prindërve dhe familjeve në mirërritjen e fëmijëve dhe të rinjve të vendit e pikërisht këto vlera që na udhëheqin edhe na kanë nxitur nga njëra anë që përherë të jemi të pranishëm aty ku bëhet fjalë për edukimin, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha tryezat institucionale, ato të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave e jo vetëm, e në vecanti në platformën e partneritetit për integrimin evropian në tryezat që Ministria ka thirrur për të diskutuar dhe adresuar çështje të ndryshme, në vazhdimësinë e sugjerimeve tona mbi zgjidhjen e problematikave; duke vënë në dispozicion të realitetit të të gjitha shkollave në vend dhe Politikën dhe procedurat e Mbrojtjes së të miturve si një sistem i brendshëm i mbrojtjes në shkolla, të cilin që prej 5 vitesh e kemi ndërtuar dhe po e implementojmë si rrjet....

Nga ana tjetër këto dy vlera na kanë frymëzuar të bëhemi nismëtarë edhe të tyre si kjo e sotmja, ku aktorë të ndryshëm mund të japin kontributin e tyre bashke me ne, gjë që dëshmon deshoren tone konkrete për një dialog, të kuptuar dhe jetuar si mundësi për t'u pasuruar ndersjelltazi me liri, me karakteristikat tona specifike dhe me vizionin dhe qasjen tonë holistike ndaj Edukimit të fëmijëve.

Nisur nga sa më sipër më lejoni të sjell shkurtimisht në emër të rrjetit të institucioneve tona dhe kontributin e mendimit tonë në këtë proces aderimi për një zhvillim cilësor në fushën e Edukimit.

1. Shkolla katolike dhe vlerat që transmeton

Ashtu sikurse Deklarata Universale e të drejtave të njeriut, edhe Gravissimum Educationis, dokument i Concilit të dytë të Vatikanit që i përket edukimit, përcaktojnë parimim sipas të cilit edukimi është një e drejtë themelore për të gjithë njerëzit.



Motër Teuta Buka

Koordinatorë Kombëtare e Edukimit Katolik Shqiptar

Shkollat që entet kishtarë, Kongregata rregulltare apo famullitë kanë themeluar, sikurse është në natyrën e shkollës, përmbushin finaliteti kulturor që e karakterizon si dhe formimi njerëzor të të rinjve

Për me tepër këto shkolla edhe pse jo shkolla fetare synojnë t'i japin jetë një ambienti komunitar shkollor të përshkuar nga shpirti ungjillor i lirisë dhe të dashurisë hyjnore

Vlerat që promovojnë që burojnë nga Ungjilli, në fakt janë vlerat universale, si Jeta dhe dinjiteti njerëzor, E verteta dhe dashuria, respekti dhe dialogu, ndershmëria dhe drejtësia, familja, puna dhe e mira e përbashkët, paqja etj. Me fjalë të tjera në një ambient edukativ të tillë përkujdesja për njeriun në tërësi realizohet dhe duke e shoqëruar të riun në pjekurimin e tij shpirtëror, emocional, intelektual dhe shoqëror. Këto përmasa i përgjigjen konceptit për njeriun sipas antropologjisë së Krishterë. Ku personi njerëzor konsiderohet i aftësuar dhe i aftë të hyjë në dialog me Botën, me të tjerët, me vetem dhe me Hyjin.

Natyrisht cdo shkollë katolike, së pari është e vetëdijshme për rolin e vet shërbyes dhe plotësues/mbeshtetës, krahas familjes që është protagonistja kryesore në edukimin e fëmijëve të vet dhe jo anasjelltas. Ajo është e qartë në vlerat që transmeton; është në kërkim të përhershëm të metodave të reja për ta bërë të mundur formimin e plotë të fëmijëve dhe bashkëndan me komunitetin edukativ vizionin e saj për njeriun dhe vlerat të cilat e frymëzojnë.

- 1. Këndvështimi i shkollave katolike mbi arsimin sot në Shqipëri*
- 2. Edukimi e mirë publike*

Sikurse edhe u tha dhe u argumentua nga ndërhyrjet e mëparshme shumë vende të Evropës e kanë të qartë, vetëdijen e të qenurit në shërbim të familjes për ta mbështetur atë. Si rrjedhojë këto vende kanë konsoliduar konceptin se edukimi është e mirë publike, domethënë i përket gjithë shoqërisë dhe natyrisht nuk është monopol i shtetit dhe as vetëm i institucioneve edukative formale. Nga garantimi i kësaj të mire, edukimit të brezit të ri, varet prosperiteti i një kombi, e ardhmja e tij dhe vitaliteti cdo shoqërie.

- 1. Përpara ndryshimeve ligjore, një pedagogji dhe antropologji (e re)*

Duke njohur nga afër sfidat e edukimit dhe të shkollave në vendin tonë mendojmë se akoma më përpara se Shqipëria të përshatet me ligjet e Evropës, duhet që të gjithë si shoqëri të thellojmë dhe dakordësojmë këndvështrimin për njeriun, për vlerat dhe për casjen edukative e cila, sot më fort se kurrë, është në krizë dhe koha na kërkon të ndyshojmë. Për më tepër në Shqipëri organet shtetërore që kanë në kujdes edukimin, duhet të clirohen nga frika e së ndryshmes, pasi vetëm duke qënë ta hapur dhe të gatshëm për dialog me të gjithë, sidomos me familjen, mund të tregojmë përgjegjësinë tonë ndaj brezit të ardhshëm.

Nuk është më koha, dhe as nevoja, të kristalizojmë në arsim, cdo procedure, cdo proces vlerësimi të jashtëm apo të brendshëm në shkollë, të përsërisim klishe të cilat të privuara nga konteksti dhe nga krijimtaria njerëzore rrezikojnë të bëhen barriera të ecjes përpara.



Motër Teuta Buka

Koordinatorë Kombëtare e Edukimit Katolik Shqiptar

Është koha të hulumtojmë, të shkojmë drejt përseve, drejt parimeve, drejt një mendimi olistik dhe kritik të mësuesve më së pari, pasi janë ata që në kontakt me të rinjtë të kenë lirinë dhe entuziazmin të eksperimentojnë, pasi janë ata që i japin përgjigje të denja nevojave të rinjve tanë sot. Vendi ynë duhet ta marrë këtë guxim që prej formimit fillestar të mësuesve dhe ta përforcojë në formimin e vazhdueshëm të tyre. E kemi të nevojshme të analizojmë shifrat si të mësuesve si të fëmijëve; mungesat në sistem, së pari numerike e mësuesve të rinj, problematikat dhe ngërcet e arsimit sot nuk duhet të na lënë indiferentë, Duke marrë guximin për të mos vijuar me implementime të risive që mbivendosen, pa bërë analiza serioze mbi rezultatet e pilotimeve, pa e parashikuar me detaje impaktin që mund të kenë në rritjen e brezit të ri dhe në cilësinë e jetës së stafëve mesimore. Ky guxim do të na ndriçojë për të kuptuar cilave gjëra duhet t'i japim rëndësi: parimeve apo formave, nevojave edukative apo programeve lëndore. Cfarë i mungon kurrikulës formative të mësuesve sot nëse jo një reflektim mbi antropologjinë dhe pedagogjinë, mbi formimin e personit njerëzor dhe etikën të cilat janë për fat të keq terma të paartikulluara mjaftueshëm në kurrikulën e formimit të mësuesve tanë në shqipëri e për rrjedhojë në krejt systemin tonë arsimor.

Pluralizmi në edukim

Në vendin tone është i madh rreziku i një burokratizimi të shterpë dhe një uniformizimi të sistemit arsimor dhe kjo nuk është në favor të së ardhmes.

Ndërsa brezi i ri na shtron detyra urgjente dhe përherë e më tepër të fushës edukative dhe formuese e jo thjesht të sferës konjitive, duket se ne po fshihemi përherë e më tepër pas burokracive. Ndoshta me dëshirën për të sistemuar gjërat e për t'u ndjerë të sigurtë që po bëjmë dicka, por në fakt nuk po zhvillojmë kapacitete njerëzore ekspertësh në pedagogji që dijnë të shkojnë tek thelbi i problematikave në arsim, por shpesh ndalen tek pasojat. Duhet edhe theksuar fakti që në fushën e arsimit këto ekspertiza duhet të jenë vendimtare dhe orientuese për zgjedhjet politike që duhet të bëhen në fushën e arsimit (dhe jo anasjelltas) Standartizimi i vazhdueshëm, dhënia e gatshme e instrumenteve me hapa të përcaktuar për të arritur “shkollën model”, nuk i shërbejnë arsimit. Në këtë prizëm shpesh përpjekjet tona si rrjet shkollash katolike, për të dhënë një kontribut të sinqertë në këtë rrugëtim bien në vesh të shurdhër. Përvojat e ndryshme që mund të sjellim edhe ne, kuptohet jo vetëm ne, metodologjitë e reja që po implementojmë, modelet gjestionale më fleksibël me të cilat cojmë përpara shkollat tona, do të ndihmonin në sfidat e edukimit të gjithë vendit tonë, për këtë është e domosdoshme që ministrinë e linjës të promovojnë hapësira të vërteta e dialogu.

Gjithpërfshirja në edukim

Shqipëria në këndvështrimin tonë është pak e vonuar në të kuptuarit e institucioneve si ministrirore-shërbyese. Në këtë fazë të shtyrë tranzicioni tashmë është e kuptueshme se kalimi, nga një shtetëzim dhe për rrjedhojë idologjizim i dikurshëm i arsimit, në një sistem të hapur promovues dhe krijues, nuk është i lehtë. Shoqëria jonë akoma e ndien ndikimin e një të kaluarë që në 4-5 dekadat e diktaturës e cila ka lënë gjurmë të thella.



Motër Teuta Buka

Koordinatorë Kombëtare e Edukimit Katolik Shqiptar

Këto janë procese që duan kohën e vet, por mendoj se tani ka ardhur momenti që në prag të përpjekjeve tona për të hyrë në Evropë të bëjmë ndryshime cilësore duke filluar nga përfshirja e të gjithë aktorëve që kontribuojnë në të mirën publike, edukimit. Pëpara se të implementojmë politika duhen hartuar ato së bashku me të gjithë aktorët.

Gjithpërfshirja si vlerë e qytetërimit Evropian duhet të fillojë që nga të qenit të hapur për të pranuar dhe mbështetur aktorët të cilët kontribuojnë në të, për të bërë të mundur përmirësimin e cilësisë edukative, që mbetet gjithmonë një objektivi për t'u arritur. Nga ky hap i parë do artikullohet më pas në hapa të tjerë përfshirja e të gjithëve në edukim, vemendja ndaj fëmijëve me aftësi ndryshe, mosdiskriminimi etj.

Garantimi efektiv i një të drejte nga ana e Shtetit

Nje element tjetër që lidhet me edukimin si të mirë të përbashkët është edhe fakti se aktorët e ndryshëm duhet të jetën së bashku partner, por edhe se shteti duhet të marrë parasysh faktin se e drejta kushtetuese për të zgjedhur edukimin gjen përgjegjen e vet reale, nëse familjeve u ofrohen vërtet propozime edukative të ndryshme dhe të larmishme, që u përgjigjen vlerave dhe nevojave të komuniteteve, natyrisht përherë sipas parimeve të Kushtetutës.

Si konkluzion

Përvoja e vendeve të evropës na tregon se në ato kontekste aty ku kanë lulëzuar një pluralizëm mundësish, casje të ndryshme mbi edukimin, kjo ka prodhuar, cilësi, liri dhe entuziazëm, si tek fëmijët ashtu edhe tek mësuesit, ka afruar shkollën me jetën konkrete dhe me zgjedhjet e përgjegjshme të individëve që janë future në botën e punës jo vetëm me njohuri të përshtatshme për me pasurinë e vet njerësore dhe me vlerat që i karakterizojnë.

Në Shqipëri nuk po ndodh akoma një gje e tillë. Ne mendojmë se krahas me reflektimin mbi antropologjinë dhe pedagogjinë duhet të bëhen edhe ndryshime në legjislacion, sikundër edhe kemi propozuar disa herë Ministrisë së Arsimit ku shprehja e pluralizmit edukativ të rregullohet qartazi; ku shkollat katolike, të kene një vend të vecantë duke zdhjeruar gamën e përkufizimeve si psh. shkolla private jofitimprurës ose më mirë akoma shkolla publike jo te menaxhuara nga shteti, publike në sajte të qenit në shërbim të së mirës publike edukimit të brezit të ri

Nuk mjafton vetëm kaq ne mendojmë se benefiti nga fondet publike i familjeve që zgjedhin këto shkolla, duhet të jetë i garantuar nga shteti, pra pjesë e buxhetit, në kuadër edhe të parimit lirisë së edukimit e cila është pika kyce e të drejtës për të zgjedhur lirisht arsimimin e cila interpretohet në dy kahe, të drejtën e shtetit për të organizuar arsimimin dhe e drejta e prindërve për të zgjedhur lirisht asimin që dëshirojnë për fëmijëne e tyre të pakushtëzuar nga kriteret ekonomike. Kjo nënkupton që meqë prindërit nuk ndodhen në kushte të mundësive të barabarta për të paguar shkollimin që ata zgjedhin për fëmijët e tyre, duhet të mbështeten duke i mundësuar akses fëmijëve të tyre në shkollat të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore pa qëllim fitimi.

Mundësia që të ketë një parashikim ligjor specifik që shteti të mbështesë këto shkolla, lind si nevojë e respektimit të parimit të laicitetit të shkollës, të drejtës së prindërve si taksapagues për të zgjedhur një shërbim publik i cili në vetvete rrit potencialin e zhvillimit individual të cdo fëmije në favor të interesit më të lartë të tij.